



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0877

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë kundër Vendimin për dhënie të një kontratë “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Parku në Kalabri- Faza e I-rë mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me numër të prokurimit 616-23-8866-5-2-1, me 05/01/2024, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë me nr. 2023/0877 , e datës 07/11/2023, kurse vendimi i AK “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Parku në Kalabri- Faza e I-rë mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me numër të prokurimit 616-23-8866-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.08.2023, “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Parku në Kalabri- Faza e I-rë mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” . Ndërsa me datën 18.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Erma Sylja B.I & AAB Constroction SH.P.K”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 99,795.00 €

Me 23.10.2023, OE “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07/11/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë me nr. 877/23 lidhur me aktivitetin “Parku në Kalabri- Faza e I-rë mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me numër të prokurimit 616-23-8866-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa Sh.P.K”- Prishtinë, janë parashtruar si në vijim:

***-Pretendimet e Operatorit Ekonomik:** “Te pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës të datës 17.10.2023 dhe me Vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim pranë AK-së të datës 30.10.2023, ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit" me numër të Prokurimit: 616-23-8866-5-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 616 23 156 521. ne afatin ligjor conform nenit 109 të LPP-së, ushtrojmë këtë ankese pranë OSHP-se: Për shkak se AK- Kuvendi i Komunës se Prishtinës :*

- *ne mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate një Grup të Operatoreve Ekonomik (GOE) i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK të vendosura ne njoftimin për kontratë-NJK dhe ne dosje te tenderit - DT.*
- *ne mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK të vendosura ne njoftimin për kontratë-NJK dhe ne dosje të tenderit –DT.*

Autoriteti kontraktues me datën 17.10.2023 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit dhe me datën 23.10.2023 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim për te ja bere me dije AK-se shkeljet e tyre qe i kane patur ne këtë aktivitet të prokurimit por AK ne vend që ti korrigjoj shkeljet e tyre ata vazhdojnë edhe me tutje me shkelje ku kërkesën tone për rishqyrtim na refuzojnë pa na dhënë kurrfarë arsytimi pra sipas AK-së se AK i ka mire administruar provat materiale që neve jemi të bindur se zyrtaret e AK-se as nuk e kane idenë se çka donë te thotë të administrohen provat materiale, AK nuk na ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me pretendimet tona vetëm se thirret ne nenin 1 pika 26 kinse neve jemi palë pa interes kurse neve i kryejmë këto shërbime ne këtë AK disa vite radhazi dhe kemi të nënshkruara disa kontrata, pra si ka mundësi të jemi pale pa interes, shihet qarte se AK është thirrur ne arsye të tyre qe as ata vet nuk e dinë pse i kane përmend këto arsye por vetëm për te krijuar huti dhe për ti mbuluar shkeljet e tyre të kundërligjshme. me poshtë po e vendosim njoftimin mbi dhënie të kontratës të datës 17.10.2023. AK ka bere shkelje të njëpasnjëshme ne këtë aktivitet të prokurimit ku se pari neve kemi kërkuar qasje ne dokumente e GOE të rekomanduar për kontratë por AK nuk na ka dhënë qasje me arsyetimin se ato dokumente janë sekrete afariste. Pra AK nuk na ka dhënë qasje ne asnjë dokument vetëm na ka ofruar deklaratën nen betim e asgjë tjetër me këtë veprim AK ka bere shkelje të rende të LPP-së nenin 10 Mjetet për promovimin e Transparencës ku ne piken 5 të këtij neni thuhet; 10.5 Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të beje dhe do ti siguroji palës se tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejt qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni. Ne këtë rast AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 11 të LPP-së Informatat Sekrete Afariste pasi që nuk ka përfillur piken 4 të këtij neni ku thuhet: Autoriteti kontraktues qe e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet një dokumentin ne te cilin po ashtu gjendet informacioni qe nuk konsiderohet të jetë sekret. Pra shihet qartë se AK haptas na ka diskriminuar duke mos na dhen qasje ne asnjë dokument për ta vërtetuar se me të vërtetë GOE i rekomanduar për kontrate a është i përgjegjshëm apo jo, dhe pasi qe AK nuk na ka dhënë qasje atëherë neve e forcojmë bindjen se me te vërtetë asnjë kërkesë të AK-së ky GOE nuk e ka plotësuar. Tani po i shënojmë një nga një kërkesat e AK-së të cilat nuk i ka plotësuar GOE të rekomanduar për kontrate. Autoriteti Kontraktues ne NJK dhe DT ka vendosur kërkesën si me poshtë : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kapaciteti teknik dhe profesional; 1. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose pune ndërtimore apo ne hapësira publike ose të ngjashme me vlere minimale prej, 100,000.00€ Euro, ne 3 (tri) vitet e fundit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1 .Dëshmi Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara (përfunduara) të natyrës se ngjashme ne tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje të referencave apo raporteve të pranimeve ne vlerën e kërkuar. Këtë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pasi qe asnjeri prej operateve të këtij grupi nuk kane kontrata të ngjashme sipas natyrës se këtij aktiviteti të prokurimit pra jo rastësisht edhe AK nuk na ka dhënë qasje ne ofertën e këtij Operatori kinse ky GOE paska plotësuar kërkesën për sekrete afariste ku shume mire dihet se sekret afarist është vetëm shuma e

mjeteve qe i posedon ne banke e asgjë tjetër pra lista e kontratave nuk është sekret afarist, neve edhe herëve tjera kemi ofertuar dhe kemi kërkuar qasje ne dokumente nga AK KK Prishtinë dhe na kane ofruar tere dokumentacionin por pasi qe kësaj radhe nuk na ofruan asgjë atëherë na është forcuar bindja se ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT. AK ka ber shkelje të njëpasnjëshme ne ketë aktivitet të prokurimit ku se pari neve kemi kërkuar qasje ne dokument e GOE të rekomanduar për kontratë po AK nuk na ka dhen qasje me arsyetimin se ato janë dokumente sekrete afariste. Pra AK nuk na ka dhen qasje ne asnjë dokument vetëm na ka ofruar deklaratën nen betim e asgjë tjetër me ketë veprim AK ka bere shkelje të LPP-së nenin 10 Mjetet për promovimin e Transparencës ku l(kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Një menaxheri i projektit; kërkohet të jete inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi -konstruktiv ose bachelor, me se paku 5 vile përvojë pune profesionale pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij ne këtë projekt të noterizuara. Edhe ketë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pra nuk ka dorëzuar Diplome, CV nuk i plotëson kërkesat e AK-së as referenca nuk është sipas kërkesës se AK-së dhe menjëherë është dashur të eliminohet si dhe i mungon marrëveshja e noterizuar e ing me OE-ne për këtë projekt dhe rrjedhimisht ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK-së të vendosura ne NJK dhe DT. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2. Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me se paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, të dorëzohet marrëveshja mbi angazhimin e tij ne këtë projekt të noterizuara. Diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij ne këtë projekt të noterizuara.”

“Edhe ketë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pra nuk ka dorëzuar Diplomë, CV nuk i plotëson kërkesat e AK-së as referenca nuk është sipas kërkesës se AK-së dhe menjëherë është dashur te eliminohet si dhe i mungon marrëveshja e noterizuar e ing me OE-ne për këtë projekt dhe rrjedhimisht ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK-së te vendosura ne NJK dhe DT. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:3.OE duhet të këtë se paku pese (5) punëtorë fizik te trajnuar për siguri dhe shëndet ne punë. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3.Dëshmia listën e punëtorëve, Certifikata e kualifikimit dhe marrëveshjen mbi angazhim ne këtë projekt. Edhe ketë kërkesë te AK-së nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar pra nuk ka dorëzuar certifikata të kualifikimit si dhe i mungon marrëveshja e noterizuar e punëtorëve me OE-ne për këtë projekt dhe rrjedhimisht ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK-së të vendosura ne NJK dhe DT. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kapaciteti teknik dhe profesional: 4.OE duhet të këtë marrëveshje me KDMK-ne për hedhjen e mbeturinave interte . Dëshmia e kërkuar dokumentare: 4.Dëshmia marrëveshja me KMDK-ne (kopje). Edhe ketë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pra i mungon marrëveshja me KMDK-ne për hedhjen e mbeturinave inerte dhe rrjedhimisht ky GOE

është i pa përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e AK-së të vendosura ne NJK dhe DT. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kapaciteti teknik dhe profesional: s. OE duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 5. Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore ose faturat e blerjes për ato automjete qe nuk kane librezat të qarkullimit. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë ne emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Edhe këtë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE të rekomanduar për kontratë pasi qe nuk i ka pajisjet të kërkuara sipas aneksit 7 të FDT-së, pra komplet ky OE i mungojnë dëshmitë për pajisjet si me poshtë: Të dorëzohet deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrëveshjet për blerjen e pajisjes ose shfrytëzimit të tij. Cisterne te ujit mbi 2:lm31 , Kamionë vet shkarkues(kiper) deri 5 ton 1 , Kamionë 8 - 12ton vet shkarkues (kiper) 2 , Kamion kiper me peshe bartëse 20-30 Ton 3 , Kamionët 1 , Eskavator me çekiq 1 , Eskavator me goma 10 deri 16 ton 1 , Ekskavator mbi 20 Ton me zingjir 1 , Ekskavator 10 deri 20 Ton me zingjir 1 , Mini ekskavator --- maksimum 5 Ton 1, Kompresor ajri 1 , Hilta 3 , Luge ngarkuese (ULTA)1”

Pra GOE të rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar kurrfarë dëshmi qe i posedon këto pajisje dhe rrjedhimisht ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe AK është dashur ta eliminoj nga kjo procedure e prokurimit. Pra shihet qarte se AK ka rekomanduar për kontratë një Grup të operatoreve të pa përgjegjshëm të cilin është dashur ta eliminoj pasi qe nuk e ka plotësuar asnjë kërkesë të AK-së, e jo ta shpërblej me kontratë. Tani po i cekim pikat e eliminimit të AK-së qe kundërligjshëm na kane eliminuar edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura ne NJK dhe DT. Arsyetim “Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: ? Ju me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar si është kërkuar ne DT dhe Njoftimin për kontratë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale është kërkuar: 1. Një menaxheri i projektit; kërkohet të jete Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi-konstruktiv ose bachelor, me se paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1, Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij ne këtë projekt të noterizuara, Ju si GOE-ik për këtë pike nuk ka dorëzuar Marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për Menaxherin e projektit si është kërkuar ne DT dhe Njoftim për Kontrate, dhe ? ju me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar siç ishte kërkuar në DT dhe Njoftimin për kontratë: tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ishte kërkuar: 2. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë, me se paku 5 vite përvojë pune profesional pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, te dorëzohet: Diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij ne këtë projekt te noterizuara. Ju si GOE-ik për këtë pikë nuk kanë dorëzuar Marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për inxhinierin e Gjeodezisë siç është kërkuar ne DT dhe Njoftim për kontratë, andaj për këtë aktivitet jeni eliminuar”. AK ka kërkuar sqarime për këto dy pika të eliminimit dhe neve i kemi dorëzuar sqarimet i kemi

dorëzuar diplomat e noterizuara për noterizimi është pas datës se hapjes për neve e konsiderojmë se plotësisht sqarimi ynë është në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-se pasi që në nenin 72 thuhet: Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duhet të jete jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktues mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacione apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla behën në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, 2, Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71. të këtij ligji. 3. Sigurimi informacioni që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pra shihet qartë se AK ka kërkuar diplomat e inxhinierëve dhe neve a kemi ofruar e që ofrimi i këtyre informacioneve është plotësisht në harmoni me pikën 3 të nenit 72, pasi që diplomat ekzistojnë para se të dorëzohen ofertat pra qëllimi i kësaj kërkesë është që të dorëzohen diplomat origjinal ose të noterizuara për ta vërtetuar se me të vërtetë diplomat janë origjinal pra neve i kemi dorëzuar diplomate e noterizuara dhe me këtë rast është vërtetuar se diplomat janë origjinal dhe ato diploma janë lëshuar para datës se hapjes se ofertave, që është në plotni me pikën 3 të nenit 72 të LPP-së ku thuhet se : Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pra diplomat kanë ekzistuar edhe para dorëzimit të ofertave që donë të thotë se ekzistenca e tyre është e fiksuar para skadimit të afatit të dorëzimit të tenderëve që mund të verifikohet në mënyrë objektive. AK duhet ta kuptoj dhe ta interpretoj drejtë këtë dispozitë të LPP-së. Me këto veprime AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimi e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të /artë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veproje në mënyrë transparente. Si dhe në pikën 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dem ose në të mirë të një ose me shumë operatorëve ekonomik. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Si dhe kemi ofertuar me çmimin me të ulët. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veproje në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët, ku AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 60 të

LPP-së.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Dardaniaa SH.P.K”. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur 1, 6, 7, 10, 59, 60, dhe 72 të LPP-së Duke propozuar qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. “Pretendimi nr. 1 - "Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e GOE të rekomanduar për kontratë por AK nuk na ka dhënë qasje me arsyetimin se ato dokumente janë sekrete afariste"

Pretendimi nr. 2 - "GOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesat nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5 të kapacitetit teknik dhe profesional".

Lidhur me pretendimet ankimor nr. 1, duhet sqaruar se për parashtruesin nuk është aspak kontestues fakti që në rastin konkret dokumentet e ofertës së tenderuesit të rekomanduar janë klasifikuar si sekrete afariste në përputhje me LPP dhe RRPP. Megjithatë për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse autoriteti kontraktues do të duhej që të ofronte qasje në këto sekrete afariste me rastin e kërkesës së parashtruesit për qasje në dokumente publike. Në këtë drejtim, përmes nenit 10 paragrafit 3 të LPP është përcaktuar se "Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i Cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. te këtij neni, përveç informatave sekrete afariste...". Nga dispozita e cituar më sipër nga LPP mund të konfirmohet se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar qasje në sekretet afariste të tenderuesit të rekomanduar pavarësisht kërkesës së parashtruesit duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 3 të LPP. Prandaj pretendimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimet ankimor nr. 2 fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi në këtë aktivitet të prokurimit është eliminuar si ofertues i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka përmbushur kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe/ ose profesional të përcaktuara përmes dosjes së tenderit. Megjithatë parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim nuk i konteston arsyet e eliminimit të tij si të papërgjegjshëm mirëpo pretendimet e veta ankimore i parashtron kundër tenderuesit të rekomanduar. Për këtë arsye parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nen paragrafit 26 të LPP përcaktohet se termi palë e interesuar nënkupton "personin që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Në rastin konkret parashtruesi nuk i konteston arsyet e eliminimit të tij si tenderues të papërgjegjshëm prandaj edhe po të vërtetoheshin pretendimet e tij në raport me tenderuesin e rekomanduar, sërish parashtruesi nuk do të mund të shpallej fitues i këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë arsye nuk mund të argumentoj interes material apo rrezik nga shkeljet e pretenduara. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore. Sidoqoftë me qëllim të shqyrtimit të plotë të

pretendimeve ankimore, vlen të theksohet se janë administruar të gjitha dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Me këtë rast është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke përfshirë edhe kërkesat me nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Rrjedhimisht pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar në tërësi, përtej faktit që parashtruesi nuk është palë e interesuar lidhur me këtë pretendim.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 877/23, ndërsa me datë 20/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0877 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, për të cilën nuk kanë dhënë përgjigje, as AK dhe as OE.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Dardaniaa SH.P.K”. ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0877 ka vlerësuar si në vijim:

-Eksperti sqaron se: “Autoriteti Kontraktues-Komuna e Prishtinës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës-punë. Vlera e parashikuar e kontratës 99,795.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, ku AK-përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 17.10.2023 potencon tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshme dhe është refuzuar për këto arsye: Nuk i keni përmbushur kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional

”Ju me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar siç është kërkuar ne DT dhe Njoftimit për kontratë: tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale është

kërkuar:1.Një menaxher i projektit; kërkohet të jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi-konstruktiv ose bachelor më se paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit .

Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. Ju si GOE për këtë pikë nuk keni dorëzuar Marrëveshjen (Kontratën)e noterizuar për Menaxherin e projektit siç është kërkuar ne DT dhe njoftimin për Kontratë dhe

Ju në ofertën tuaj nuk e keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar siç është kërkuar ne DT dhe Njoftimit për kontratë: tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:2.Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2.Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, të dorëzohet: Diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. Ju si GOE për këtë pikë nuk keni dorëzuar Marrëveshjen (Kontratën)e noterizuar për Inxhinierin e gjeodezisë siç është kërkuar ne DT dhe njoftimin për Kontratë andaj për këtë aktivitet jeni eliminuar.

Kundër njoftimit B58 njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim. AK me datë 30.10.2023 nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK-Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 11, 59, 60 dhe 72 të LPP-së, dhe dispozitat përkatëse të Rregullave të KRPP-së, kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se është eliminuar pa të drejt dhe kundërligjshëm nga ana e AK-së edhe pse pretendojnë se i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së, të vendosura në DT dhe NJK. Autoriteti kontraktues-Komuna e Prishtinës ka kërkuar sqarime shtesë për këto dy pika të eliminimit dhe neve i kemi dorëzuar diplomat e noterizuara por noterizimi është pas datës se hapjes. Tutje OE ankues shton se konsiderojmë se sqarimi ynë është në harmoni me nenin 59 dhe 72 par 1, 2 dhe 3 të LPP-së, pasi qe diplomat ekzistojnë para se të dorëzohen ofertat pra qellim i kësaj kërkesë është që të dorëzohet diploma origjinale ose të noterizuara për ta vërtetuar se ne të vërtet diplomat janë origjinale pra ne i kemi dorëzuar diplomat e noterizura dhe me këtë rast është vërtetuar se diplomat janë origjinale dhe janë lëshuar para datës se hapjes se ofertave qe do thotë se ekzistenca e tyre është e fiksuar para skadimit të afatit të dorëzimit te tenderëve qe mundë të verifikohet në mënyrë objektive. Ekspertja shqyrtuese, sqaron se fillimisht AK me datën 04.10.2023, përmes letrës standarde për sqarim të tenderit ka kërkuar nga OE ankues që ti bashkangjet dokumentet si në vijim:

“Diplomën e Inxhinierit te gjeodezisë referencat qe dëshmojnë provojnë e punës (5 vite pas diplomimit) siç është kërkuar ne DT dhe njoftimit për kontratë.”

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se AK ka kërkuar tek kërkesat 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar me tender dokumentin me titull “Stafi Profesional 1.Pdf”, ku në mesin e kësaj liste janë Rustem Abazi inxhinieri i ndërtimtarisë dhe inxhinieri i gjeodezisë Ibrahim Jonuzi.

Për Rustem Abazi inxhinieri i ndërtimtarisë është bashkangjitur: Diplomë, e njëjta me vërtetime noterial të kopjes nga origjinali me nr. LRP Nr. rendor 10742/2023, CV, Referencë pune, Dëshmia se i njëjti do jete Menaxher i projektit për këtë tender, Kontrata e punës e lidhur me datë 01.06.2023, e nënshkruar nga palët punëdhënësi “Dardaniaa shpk” dhe punëmarrësi Rustem Abazi.

Po ashtu për Ibrahim Jonuzi inxhinieri i gjeodezisë me ofertë e OE ankues është bashkangjitur: Licenca me nr.105 me afat të skadimit te licencës 15.10.2025, e njëjta me vërtetime noterial i kopjes nga origjinali me nr. LRP Nr. 6900/2022,CV, Dëshmia se do jete Gjeodet i projektit për këtë tender, Referencë pune, Kontrata e punës e lidhur me datë 01.06.2023, e nënshkruar nga palët punëdhënësi “Dardaniaa shpk” dhe punëmarrësi Ibrahim Jonuzi.

Provë; Lista e Stafit profesional bashkangjitur me tender nga OE “Dardania” shpk

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se bazuar në kërkesën për sqarim të tenderit të datës 04.10.2023, nga AK, letrën standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 17.10.2023, dokumente e dorëzuara nga OE ankues sipas kërkesë së AK dhe dokumentet e dorëzuar me tender ashtu siç u ceken me lart si dhe vërejtjen e vendosur në DI të AK-së “Vërejtje: Për te gjitha diplomat-kualifikimet e arritura (persona te diplomuar) ne vendet jashtë Republikës se Kosovës kërkohet qe diploma e tyre te jenë të noterizuar ne Republikën e Kosovës”. Ekspertja shqyrtuese vlerëson se sqarimi i dhënë të “vërejtjet”, precizohet se noterizimi vlen për diploma të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës, kurse gjeodeti Ibrahim Jonuzi ka përfunduar studimet në fakultetin e Ndërtimtarisë në kuadër Universitetin e Prishtinës, që nënkupton se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që diploma e fituar në Republikës e Kosovës të jetë e noterizuar. Sido që të jetë, noterizimi i diplomës së fakultetit të fituar në Kosovë dhe diplomës së masterit të fituar në Republikës e Shqipërisë, pas sqarimeve të AK-së, nga ana e operatorit ekonomik ankues përkatësisht me datën **02.10.2023**, nuk mund ta penalizoj OE ankues për faktin se diplomimi i inxhinierit është para se të dorëzohen ofertat, përkatësisht në vitin 2011 përfundimi i studimeve themelore dhe përfundimi i masterit në vitin 2019, noterizim i këtyre dy diplomave ka për qellim vërtetimin se diplomat janë origjinale dhe janë lëshuar para datës se hapjes se ofertave, që do thotë se ekzistenca e tyre është e fiksuar para skadimit të afatit të dorëzimit të tenderëve, që mund të verifikohet në mënyrë objektive sipas nenit 72 paragrafi 3 i LPP-së. Pra, diplomat e fituara janë shumë vite para datës së publikimit të njoftimit për kontratë dhe nuk përbën ndryshim material. Po ashtu me ofertë OE ankues ka bashkangjitur kontrata e punës për këta dy inxhinierëve të cilit i ka prezantuar si staf dhe të punësuar nga data 01.06.2023, para njoftimit për kontratë 22.08.2023, dhe datës së dorëzimit të ofertave 12.09.2023. **Andaj pretendimi i OE**

ankues është i bazuar.

Provë; Diplomat e inxhinierit të gjeodezisë Ibrahim Jonuzi dhe kontrata e punës me OE ankues.

Sa i përket pretendimi të OE ankues “Dardaniaa” sh.p.k-Prishtinë, kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues pretendon se nuk ju ka ofruar qasje “përveç deklaratës nen betim dhe asgjë tjetër” dhe AK me këtë rast ka bërë shkelje të nenit 10 pika 5 të LPP-së, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t’i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.” Po ashtu, OE pretendon se AK ka bërë shkelje edhe të nenit 11 të LPP-së, dhe njëherit potencon në ankesë se forcojmë bindjen se me të vërtetët asnjë kërkesë të AK-së nuk e ka plotësuar GOE të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti pretendon kinse nuk janë plotësuar asnjëra nga Kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nenin 9.1 & 9.2 të DT, përkatësisht kërkesat nr. 1.1.2,3,4 dhe 5.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në njërin anë OE ankues pretendon që nuk ka pas qasje, ndërsa në anën tjetër pretendon se OE i rekomanduar nuk i plotëson asnjë kërkesë të AK-së, sido që të jetë, ekspertja shqyrtuese sqaron se mohimi i qasjes në dokumente i a pamundëson operatorëve ekonomik konkurrues mbledhjen e informatave konkrete dhe të nevojshme të cilat mund të përdoren për ushtrimin e të drejtës për ankesë. Neni 11 i LPP-së paragrafi 3 pika 3.3 dhe 4 qartë përcakton që: OE i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet të argumentoj përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet të vërtetohet se ndonjëra nga elementet e tenderit nuk është pronë publike dhe të dhënat mbrohen dhe në detaje do të arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti, ku zbulimi i tyre do të rezultonte me dëmtim material apo komercial të operatorit ekonomik. Po ashtu, paragrafi 4 i këtij neni përcakton se AK që e klasifikon një element të informatës si sekret afarist, detyrimisht duhet të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret.

Andaj ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim do duhet ti jep qasje OE ankues sipas dispozitave të lartpërmendura, duke përgatit versionin e pastruar të dokumenteve sepse lista e stafit, kualifikimet e stafit, mjetet punës/pajisjet, lista e kontratave, marrëveshja për hedhjen e mbeturinave me KDMK-në, etj. të cilat pretendon OE ankues se GOE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson, nuk mund të konsiderohen si sekrete afariste dhe në rastin konkret e shohim shumë të vështirë të arsyetohet se qasja në dokumente të tilla të cilat i cekem si më lartë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik, pika (ii) e nenin 11 par.3 nën par.3.3 të LPP-së, kur informata si lista e kontratave dhe refencat në të shumtën e rasteve janë të lidhura me autoritetet kontraktues dhe janë kontrata publike. Andaj AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, 11 të LPP-së, si dhe nenin 7 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Pretendimi i OE ankues e kualifikojmë si të bazuar.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar edhe në kërkesën për rishqyrtim, ankuesi të njëjtat pretendime i ka potencuar kundrejt grupit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, ndërsa OE ankues nuk ka marrë përgjigje nga ana e autoritetit kontraktues Komuna e Prishtinës, përmes vendimit të datës 30.10.2023, me këtë veprim AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, paragrafi 8, pika 8.4, i nenit 108/A të LPP-së, sepse kjo dispozitë përcakton që AK, do ta refuzoj një kërkesë për ri shqyrtim kur: “Autoriteti Kontraktues e ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptim të asaj që kërkohet nga ankuesi”. Përderisa paragrafi 9, i nenit 108/A, të LPP-së, përcakton që: “Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj parashtruesit të ankesës dhe te gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë...”. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa SH.P.K”. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa SH.P.K”. janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Nga sqarimet e dhëna më sipër, konkludohet se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa SH.P.K”. Argumentimi në raportin e ekspertizës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e dhëna mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” me numër të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veprohet në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu vlenë të theksohet se paneli shqyrtues nuk është lëshuar në asnjë konstatim sa i

përket OE të rekomanduar për kontratë për shkak se pala ankimore nuk ka pasur qasje të plotë dhe konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues AK duhet tja lejoj qasjen ankuesit.

-Përfundim-

Konform pretendimeve ankimore dhe përgjigjeve të dhëna nga autoriteti kontraktues pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, shihet se AK gjatë ekzaminimit të kësaj procedurë të prokurimit nuk ka vepruar në bazë të dispozitave të LPP-së, kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 10, 11, 72, dhe 108/A të LPP-së. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim AK-së do duhet të veproj sipas kërkesave të DT dhe NJK, sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues marre për bazë mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, vlerëson që aktivitetin e prokurimit në këtë rast ti nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1. Paneli shqyrtues obligon AK-në që të veprojë konform këtij vendimi dhe rekomandimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues, në pajtim me të gjitha dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit sekondar në fuqi.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin i prokurimit të kthehet sërish në **ri-vlerësim**.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DARDANIAA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: